

KONTRATE TRANSFERIM KAPITALI

E lidhur ne Sarande sot me daten 19/09/2000, diten e marte, midis paleve kontraktuese:-----

TRANSFERUESI: Jani Papajani, i biri i Vangjelit, i datelindjes 1952, banues ne Delvine, me zotesi juridike.

FRANUESIT: Alqi Papajani, i biri i Vangjelit, i datelindjes 1954, banues ne Sarande, me zotesi juridike.

Timotheo Papajani, i biri i Vangjelit, i datelindjes 1956, banues ne Sarande, me zotesi juridike.

Jorgo Papajani, i biri i Vangjelit, i datelindjes 1960, banues ne Delvine, me zotesi juridike.

Roland Papajani, i biri i Vangjelit, i datelindjes 1963, banues ne Delvine, me zotesi juridike.

Palet me vullnetin e tyre te lire dhe te pavesuar lidhen kete kontrate per transferimin e kapitaleve:-----

"Transferuesi Jani Papajani i cili eshte ortak ne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "DINAMIKA"SH.P.K. kerkon te largohet nga shoqeria dhe kuotat e tij ne kapitalin fillestar qe jane 20 ose 6.760.000 leke ua transferon te kater ortakeve te tjere dhe konkretisht Alqi Papajanit, Timotheo Papajanit, Jorgo Papajanit dhe Roland Papajani ne pjese te barabarta duke u dhene nga 5 kuota secilit ose nga 1.690.000 leke. Ne keto kushte te kater ortaket behen me nga 25 kuota ose 8.450.000 leke ne gjithë kapitalin e shoqerise qe eshte 100 kuota ose 33.800000 (tredhjetetre milion e teteqind mije)leke. -----

Largimi i ortakut Jani Papajani eshte bere duke qene se nuk ka respektuar vendimin nr.3 date 04/08/1998 te Asamblese se ortakeve te shoqerise "DINAMIKA"SH.P.K. ku theksohej se ne rast moslikujdimi te shumes prej 5.080.000 qe i korespondon rritjes se kapitalit te shoqerise me nje shume prej 25.400.000 leke brenda tremujorit te pare te vitit dymije ahere vete Jani do te largohet nga shoqeria duke ua transferuar kuotat e tij ortakeve te tjere. Sipas vendimit nr.3 te Asamblese date 04/08/2000 Jani kishte 20 kuota ose 1.680.000 leke ne kapitalin e shoqerise prej 8.400.000 leke. Kjo theksohet edhe ne vendimin nr. 9.063/2 date 7/5/1996 te Gjykates se rrethit Tirane. Me rritjen e kapitalit ne shumen 25.400.000 leke duke u bere keshtu gjithsej 33.800.000 i gjithë kapitali i shoqerise, ortakut Jani Papajani nuk ka kontribuar. Ne keto kushte duke qene se se vet Jani nuk kontriboj me pjesen e tij ne rritjen e kapitalit ne shumen 25.400.000 leke qe i

korespondon shuma per vete Janin qe duhet te likujdonte ne 5.080.000 leke por keto i kane likujduar te kater ortaket e tjere Alqi Papajani, Timotheo Papajani, Jorgo Papajani dhe Roland Papajani, nuk i takon qe ta kthehet shuma e mesiperme. Ortakut Jani Papajani i takon ti kthejne shumen prej 1.680.000 leke te kater ortaket e tjere duke qene se kaq eshte kontributi i tij ne kapitalin e shoqerise prej 8.400.000 leke. Siq theksuam edhe me larte ne rritjen tjeter te kapitalit vete Jani nuk ka kontribuar per shkak te veshtiresive financjare dhe kjo u be edhe shkak per largimin e tij nga shoqeria. -----

Te kater ortaket Alqi Papajani, Timotheo Papajani, Jorgo Papajani dhe Roland Papajani i pranojne kuotat e dhena nga ortakut Jani Papajani duke ngelur keshtu shoqeria me kater ortak dhe me kuota te barabarta.

Likujdimi i shumes prej 1.680.000 leke behet ne prezencen time noterit qe formulom kete kontrate transferimi Artan Lulaj. -----

Kontrata e transferimit bazohet ne nenet 45-49 te ligjit nr.7638 date 19/11/1992 "Per shoqerite tregtare", ne vendimin nr.5 date 19/09/2000 te Asamblese se ortakeve te shoqerise si dhe ne nenin nr.9 te statutit te shoqerise. -----

Persa me siper meqenese eshte ne perputhje me ligjin dhe vullneti e lire te paleve, nenshkruhet rregullishte prej tyre. -----

T R A N S F E R U E S I

JANI PAPAJANI

P R A N U E S I T

ALQI PAPAJANI

JORGO PAPAJANI

TIMOTHEO PAPAJANI

ROLAND PAPAJANI

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA SARANDE

NR. 1867 REP.

NR. 936 KOL.

V E R T E T I M

Sot me daten 19/09/2000 para meje noterit Artan Lulaj u paraqiten personalishte zoterinjte Alqi Papajani, Jani Papajani, Timotheo Papajani, Jorgo Papajani dhe Roland Papajani, madhor dhe me zotesi juridike, te njohur prej meje te cilet pasi u lexua kjo kontrate transferimi rane dakorte dhe e firmosen ne prezencen time.

Une noterit vertetoj firmat e vena konforme ligjit.



N O T E R I

ARTAN LULAJ

KONTRATE SHITBLERJE KAPITALESH

Sot me daten 22/04/2005, ditën e premte para meje noterit të noterisë Delvine Shkelqim Haxhi me zyrë në qytetin e Delvines u paraqiten personalisht palet kontraktuese: -----

SHITESA:ALQI PAPAJANI , i biri i Vangjelit ,i datelindjes 1954, banues në Sarandë , me zotësi juridike .

TIMOTHEO PAPAJANI,i biri i Vangjelit,i datelindjes 1956 banues në Sarandë, me zotësi juridike .

JORGO PAPAJANI, i biri i Vangjelit , i datelindjes 1960, banues në Delvine, me zotësi juridike .

ROLAND PAPAJANI,i biri i Vangjelit , i datelindjes 1963, banues në Delvine, me zotësi jurike .

BLERES: Jani Papajani, i biri i Vangjelit ,i datelindjes 1952,banues në Delvine, me zotësi juridike .-----

Palet me vullnetin e tyre të lire dhe të pavesuar kerkuan hartimin e kontrates së shitblerjes së kapitaleve si me poshtë:-----

Me vendimin nr. 9063 datë 21/02/1995 të Gjykatës së shkallës së parë Tirane është regjistruar si person juridike shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "DINAMIKA" SH.P.K.-----

Me vendimin nr. 6 të Asambles së ortakëve të shoqërisë ortakët e kësaj shoqërie Alqi Papajani, Timotheo Papajani, Jorgo Papajani dhe Roland Papajani me dëshirën e tyre i kanë shitur nga kapitali I tyre në shoqëri që është nga 25 kuota ose 8.450.000 leke për secilin në kapitalin e shoqërisë prej 100 kuota ose 33.800.000 Jani Papajanit nga 5 kuota ose 1.690.000 leke secili. Në kushtet e shitjes nga 5 kuota ose 1.690.000 leke secili nga ortakët tek Jani Papajani I cili futet edhe si ortak I ri në shoqëri, shoqëria behet me pesë ortak të cilët behen përkatesishte nga 20 kuota ose 6.760.000 leke secili në kapitalin e shoqërisë prej 100 kuota ose 33.800.00 leke.-----

Bleresi Jani Papajani I pranoi kuotat e shitura nga ortakët Alqi Papajani, Timotheo Papajani, Jorgo Papajani dhe Roland Papajani duke e bërë kështu shoqërinë me pesë ortak dhe me kuota të barabarta.-----

Likujdimi I gjithë shumës prej 6.760.000 leke që u detyrohet të kater ortakëve behet në prezencën time noterit që formulon këtë kontratë shitje Shkelqim Haxhi.-----

Kontrata e shitjes së kapitaleve bazohet në nenin 47 të ligjit nr.7638 datë 19/11/1992 "Për shoqëritë tregëtare", në vendimin nr. 6 datë 22/04/2005 të Asamblesë së ortakëve të shoqërisë si dhe nenin nr.9 të statutit të shoqërisë.-----